




INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Analiza për shpenzimet dhe përfitimet nga politika për tërheqjen dhe rritjen e investimeve të huaja direkte në Republikën e Maqedonisë



Stërvitje:

Autorë

Jordanço Minevski

Qendra qytetare për zhvillim të qëndrueshëm EGRI, Kriva Palanka

Emilija Nikolova

Ivan V'çkov

Finance Think - Instituti për hulumtime ekonomike dhe politike, Shkup

Mentorë: Vladimir Filipovski¹ – Fakulteti ekonomik, Skopje

Përktheu: Zejnula Veseli

¹ Qëndrimet e shprehura në studimin janë qëndrime të autorëve dhe mentori jo domosdoshmërisht pajtohet me të njëjtit

HYRJE

Qeveria e Maqedonisë në vitet e kaluara udhëheq politikë stimuluese për tërheqjen dhe rritjen e investimeve të huaja direkte në shtet. Vlerësimi i përgjithshëm është se ata janë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe zhvillim. Për realizimin e këtyre politikave janë angazhuar dy institucione të mëdha shtetërore: Agjencia për investime të huaja direkte dhe promovimin e eksportit në Republikën e Maqedonisë (AIHDPERM) dhe Drejtoria për teknologji industriale në zonat zhvillimore (DTIZZH). Janë emëruar dhe ministra pa resor të angazhuar për tërheqjen e investimeve të huaja si dhe janë angazhuar edhe promotorë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë realizon dhe jashtë vendit për promovimin e Maqedonisë si destinacion i volitshëm për investime të huaja dhe promovon fushatë të sforcuar reklamuese në media të huaja prestigjioze. E gjithë kjo bëhet për promovimin e lehtësimeve të shumta që shteti ofron për investitorët e huaj siç janë lirimi pesëvjeçar nga tatimi personal si dhe ndihmat direkte shtetërore përmes subvencioneve. Pikërisht kjo politikë stimuluese e Qeverisë për investitorët e huaja është lëndë diskutimi dhe kundërshtimeve në opinion për një periudhë kohore afatgjate. Arsyeja kryesore për diskutimin e këtyre politikave është efikasiteti i harxhimeve të parave shtetërore dhe dhënien e subvencioneve investitorëve të huaj përmes kësaj politike. Me qëllim të përcaktimit dhe kuantifikimit të harxhimeve që dalin nga realizimi i kësaj politike nacionale, në njërën anë janë harxhimet nga kjo politikë dhe në anën tjetër janë përfitimet (kost-benfitet). Me kuantifikimin e harxhimeve dhe përfitimeve politike mund të përcaktohet neto efekti i tyre.

Sipas Doracakut për analiza të harxhimeve dhe përfitimeve të Komisionit Evropian (KE) (European Commission, 2014), ky doracak është elementi kyç për miratimit e vendimeve për projekte investuese shtetërore. Analiza është pjesë e strategjisë për zgjedhjen e projekteve me të mira dhe cilësore të cilat ofrojnë vlera më të mirë të parave të cilat kanë ndikim të dukshëm pozitiv në realizimin e këtyre projekteve. Analiza e harxhimeve dhe përfitimeve është mjet që i përfshinë harxhimet e përgjithshme për realizimin e një programi publik me qëllim që të zgjidhet opsioni më i qëndrueshëm ekonomik. Kjo analizë e përdorur shpesh nga qeveritë ka për qëllim të vlerësohet leverdia e një programi të caktuar. Qëllimi i analizës është që të mund të shihen se realizimet e përgjithshme të hyrave të pritura nga politikat stimuluese i tejkalojnë harxhimet. Ky mjet analitik ofron shpërndarjen më të lehtë të resurseve, e analizon përshtatshmërinë e programit në ndryshimin e mirëqenies të një shoqërie përmes realizimit të një programi të përcaktuar.

Qëllimet e kësaj analize janë:

- të rritet transparenca e harxhimeve fiskale në Republikën e Maqedonisë,
- të përcaktohet lartësia e harxhimeve qeveritare dhe të ndjehet efekti i tyre
- të jepen rekomandime të bazuara në të dhënat e fituara gjatë realizimit të kësaj analize.

Analiza e programit është kombinim i eks post dhe i eks ante. Analiza përpunohet për periudhë kohore prej vitit 2006 deri në vitin 2020. Prej vitit 2006 deri në vitin 2014 në analiza janë treguar dhe shfrytëzuar të dhënat faktike derisa nga viti 2015 deri në vitin 2020 janë treguar të dhëna të projektuara.

Tërheqja e investimeve të huaja direkte (IHD) ka për qëllim të përmirëson gjendjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Sipas programit të Qeverisë së RM (Влада на РМ, 2014) përmirësimi i gjendjes ekonomike është në shumë sfera:

- Rritja e investimeve të huaja direkte në vend
- Krijimin e më shumë se 10.000 vende pune
- Rritja e eksportit deri më 10 për qind dhe rritja e importit prej 8 për qind në nivel vjetor
- Uljen e papunësisë përmes investimeve të reja në zonat ku do të hapen vende të reja pune a
- Nxitjen e bashkëpunimit të kompanive vendore me investitorët e huaj, në drejtim të përfshirjes të kompanive vendore në zinxhirin e furnizuesve të kompanive të huaja që punojnë në Republikën e Maqedonisë. – Zonat zhvillimore teknologjike industriale (ZZHTI) që do të mundësojnë zhvillim të barabartë rajonal.

FAKTET E PËRGJITHSHME TË GJENDJES MAKROEKONOMIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË PREJ VITIT 2006 DERI NË VITIN 2015

Gjendja makroekonomike në Maqedoni ka rol të rëndësishëm në analizën tonë. Politika e tërheqjes së IHD në masë të madhe varet dhe ndikon në gjendjen makroekonomike të shtetit. Për këtë qëllim do ti shqyrtojmë treguesit e rëndësishëm makroekonomik që janë të lidhura me këtë politikë, e ajo është shkalla e papunësisë, shkalla e rritjes reale të BPB, shkalla e investimeve direkte dhe bilancit tregtar në Republikën e Maqedonisë.


Sipas grafikut 1, prej vitit 2006 deri në kuartalin e tretë të vitit 2015 shkalla e papunësisë ishte 25,5 për qind. Ky zvogëlim i papunësisë mund të jetë si ndikim i shumë faktorëve, njëri prej të cilëve është dhe hapja e vendeve të reja të punës nga IHD-ë.

Sipas grafikut 2, më poshtë, rritja e Bruto Prodhimit të Brendshëm (BDB) në Maqedoni është më i lartë në vitin 2006, 2007 dhe në vitin 2008. Bruto Prodhimi i Brendshëm ka shënuar shkallë negative në vitin 2009 dhe në vitin 2012. Në përgjithësi Bruto Prodhimi i Brendshëm shënon progres nga viti 2006 deri në kuartalin e tretë të vitit 2015.


INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Sipas grafikut 3, investimet e huaja direkte në Maqedoni kanë shënuar rritje më të madhe në vitin 2006, 2007 dhe në vitin 2008. Mesatarisht prej vitit 2006 e deri në kuartalin e tretë të vitit 2015 investimet direktet marrin pjesë me 3,45 për nga Bruto Prodhimi i Brendshëm në vend. Duhet të cekët se llogaritjet e investimeve direkte nga BPRM janë transaksione investuese ndërkombëtare për përfitime afatgjate të interesave ekonomike të kompanisë që është rezident në ekonomi ndryshe nga ajo e investitorit ku janë përfshirë të dhëna të vetanake (reinvestim të fitimit).

Grafiku 1:
Shkalla e papunësisë




Grafiku 2:
Shkalla e BDB rritje reale




Në grafikun 4, është paraqitur bilanci tregtar i Republikës së Maqedonisë prej vitit 2006 deri në vitin 2014. Bilanci tregtar është paraqitur përmes importit dhe eksportit për periudhë të caktuar. Kemi vërejtur se në vazhdimësi importi është më dominues se eksporti përgjatë viteve. Edhe pse importi shënon rritje, tendenca e eksportit është të rritet në pajtim me rritjen e importit. Bilanci tregtar në vend është negativ dhe eksporti mesatarisht për këto vite është për 56,5 për qind më i ulët se importi në vend.

Grafiku 3:
IHD



* Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (2016)

Grafiku 4:
Bilanci tregtar



* Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (2016)

DEFINIMI I PALËVE TË PËRFSHIRA DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Fokusi i kësaj analize do të jetë se a ka Maqedonia interes nga implementimi i kësaj politike. Siç thamë më lartë sipas doracakut të KE-së, qëllimi ynë është të analizojmë se sa përfitimet që i fiton vendi nga IHD i mbulojnë harxhimet nga zbatimi i kësaj strategjie. Në përgjithësi ne analizojmë se a ka dallime pozitive midis përfitimeve dhe harxhimeve të strategjisë. Të dhënat që i shfrytëzuar për analizën tonë janë buxheti prej vitit 2008 deri në vitin 2015 i AIHDPERM dhe DTIZZH. Për vitin 2006 dhe vitin 2007 shfrytëzuar buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, si organ përgjegjës për zbatimin e strategjisë për tërheqjen e investimeve të huaja në RM ku janë paraqitur nën programet e dhëna të AIHDPERM dhe DTIZZH. Të gjitha të dhënat e tjera nga përfitimet që i marrin këto kompani siç janë lirimi nga tatim fitimi janë marrë nga informatat e Drejtorisë për të Ardhura Publike (DAP) dhe nga raportet financiare të 14 kompanive të huaja prezentë në DTIZZH dhe në zonat industriale.

Patjetër duhet të cekim se kjo strategji e qeverisë është e përgjithshme dhe përfshihen shumë sektorë tjerë në Maqedoni. Sektorë tjerë ku zbatohet kjo strategji janë realizmi i zonave të lira shëndetësore, tërheqjen e investimeve të huaja në turizëm, tërheqjen e IHD në bujqësi dhe në industrinë e tekstit. Analizën tonë e specifikojmë vetëm për firmat që janë prezent në DTIZZH për shkak të faktit se firmat këto firma deri më sot janë si storie të suksesshme sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja nga Qeveria e Maqedonisë. Këto firma gjithashtu janë të orientuar ka eksporti njëherit janë prezantuar si punëdhënësit më të mëdhenj në Maqedoni. Për këtë është e logjikshme të supozohet se këta 14 kompani të huaja kanë kontribuar në rritjen e eksportit dhe rritjen e punësimeve në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të qëllimeve të kësaj strategjie që përmendet nga Qeveria e RM, ne realizuam analizën për at se kush janë palët e përfshira në programet qeveritare për tërheqjen e investimeve të huaja. Sipas qëllimeve dhe ndikimeve që ka kjo strategji palët e përfshira janë Qeveria, personat e papunë në, ndërmarrjet vendore, popullata dhe ekonomia e RM-së. Qeveria e RM-së është palë e involvuar me vetë faktin se realizon programin me para të buxhetit shtetëror të cilat harxhohen për zbatimin e strategjisë. Personat e papunë janë palë e involvuar për shkak se njëri prej qëllimeve që ka kjo strategji është se me për tërheqjen e investimeve të huaja të zvogëlon papunësinë. Firmat vendore janë palë e involvuar në këtë strategji për shkak të nxitjes së bashkëpunimit me kompanitë e huaja vendore në zona dhe transferimin e njohurive të tyre know – how). Popullata është palë e involvuar e kësaj strategjie për faktin se qeveria këtë strategji e realizon me parat e fituara të qytetarëve. Ekonomia e është palë e involvuar sepse qëllimi i këtij programi është të nxit eksport më të madh dhe për bashkëpunimin e firmave vendore me firmat e huaja që në mënyrë indirekte do të nxiste rritje dhe zhvillim më të madh ekonomik.

ANALIZA PËR SHPENZIMET DHE PËRFITIMET

SHPENZIMET

Shpenzimet për funksionimin e Agjencisë për investimet e huaja direkte dhe promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë (AIHDPERM)

Sipas Ligjit për themelimin Agjencisë për investimet e huaja direkte dhe promovimin e eksportit të Republikës së Maqedonisë (AIHDPERM) në vitin 2010, Agjencia ka më shumë kompetenca lidhur me tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe promovimin e eksportit. Mjetet për kryerjen e veprimtarisë i siguron përmes transfereve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Deri në vitin 2007 programi D8 – Agjencia për investime të huaja e RM-së është nën programi i Programit për zhvillim ekonomik dhe realizohet përmes Ministrisë së Ekonomisë. Nga viti 2008 AIHDPERM bëhet shfrytëzues buxhetor i veçantë. Si shpenzime merren të dalat e përgjithshme të caktuara të agjencisë sipas Buxhetit të RM-së. Të dalat e AIHDPERM janë vendosur programet dhe nën programet që i zbaton. Programe janë AIHDPERM (nën programe janë AIHDPERM dhe marketingu ekonomik) dhe zhvillimi ekonomik (nën programe: Promovimi ekonomik dhe Përkrahja e investimeve) nga Buxheti i RM-së i viteve, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016. Të dhënat për të dalat për vitin 2006 dhe 2007 për këtë agjenci janë marrë nga Ministria e Ekonomisë për shkak se në këto vite udhëhiqet si nën programi i Ministrisë së Ekonomisë. Gjithashtu në këto vite „Invest in Macedonia“ është realizuar sipas programit D4 Promovimi ekonomik (Бюџет на РМ, 2007). Në vetë buxhetin e agjencisë janë përfshirë rrogat e administratës si dhe të promotorëve ekonomik që punojnë për promovimin e mundësive ekonomike që do të fitonin kompanitë e huaja nëse do të investonin në Maqedoni.

Në vitin 2006 agjencia për investime të huaja merr transfere nga Ministria e Ekonomisë. Si pjesë e buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë në programin për zhvillim ekonomik, nën programin D5, me përshkrim: tërheqja e investimeve të huaja dhe zhvillimin e zonave të lira ekonomike shuma e caktuar për agjencinë e investimeve të huaja është 48.027.000, denarë. Gjithashtu në kuadër të kësaj vlerë është caktuar dhe shuma e harxhimeve për zhvillimin e zonave të lira ekonomike.

Në vitin 2006 agjencia merr transfere nga Ministria e Ekonomisë. Këto transfero janë si pjesë e buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë në programin për zhvillim ekonomik, nën programi D5, dhe thotë kështu : Agjencia për investime të huaja e RM-së nga buxheti i ndahen 207.370.000 denarë dhe i është shtuar vlera e nën programit D4 me përshkrim: Investime të huaja dhe promovimi në vlerë prej 63.820.000. denarë Për vitin e njëjtë fiton transfero edhe nga programi D5 e Ministrisë së Ekonomisë, si pjesë e programit për zhvillim. Përshkrimi është tërheqja e investimeve të huaja direkte dhe zhvillimin e zonave të lira ekonomike. Në buxhetin e AIHDPERM ka një paragraf të veçantë për promocion ekonomik e cila tregon se vlera e përcaktuara është shfrytëzuar për këtë qëllim.

Nga viti 2008 deri në vitin 2015 ka harxhime faktike të fituara nga rishikimi i buxhetit, ndërsa për vitin 2016 vlera është projektuar nga ana e Qeverisë. Për qëllimet e analizës sonë janë bërë projeksionet e harxhimeve për funksionimin e AIHDPERM prej vitit 2014 deri në vitin 2020. Për periudhën 2008-2014 është llogaritur për çdo vit se sa është përqindja pjesëmarrjes në buxhetit e AIHDPERM në nominalen e BDB-së. Vlera e projektuar e BDB-së për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 është sipas shkallës së rritjes që e parasheh Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe është shumëzuar me mesataren e përqindjes së AIHDPERM në BDB-në dhe kështu është fituar se sa ka qenë për një vit vlera e buxhetit të Agjencisë për investime të huaja.

Harxhimet për funksionimin e Drejtorisë për zhvillim të zonave teknologjike industriale (DZHZTI)

Drejtoria për zhvillimin e zonave teknologjike industriale (DZHZTI) e themeluar me Ligj për zona të lira ekonomike në vitin 1999, megjithatë sipas Ligjit të drejtorisë për zhvillimin e zonave teknologjike industriale i vitit 2007, kjo drejtori fiton më shumë kompetenca. Harxhimet e drejtorisë janë marrë nga Buxheti i RM-së prej vitit 2008 – 2016, të paraparë për drejtorinë. Arsye se pse po merren harxhimet totale të Drejtorisë është për shkak se Drejtoria është shfrytëzues buxhetor i cili shfrytëzon një pjesë të buxhetit për tërheqjen dhe për përkrahjen e investimeve të huaja direkte, kështu që për realizimin e strategjisë për tërheqjen e investimeve të huaj direkt ky shfrytëzues duhet të llogaritet si harxhues ekstra i shtetit në zbatimin e strategjisë.

Për periudhën 2008 – 2014 për çdo vit është llogaritur se sa është përqindja e Buxhetit të DZHZTI-së në nominalen e BDB-së. Pastaj është llogaritur mesatarja e buxhetit të projektuar. Vlera e projektuar e BDB-së për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 është sipas shkallës së rritjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për vitin 2015 dhe është shumëzuar me mesataren e përqindjes së DZHZTI-së në BDB-në dhe kështu është fituar se sa ka qenë për një viti vlera e buxhetit e kësaj drejtorie.

Në pajtime me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të DZHZTI, shpërndarësit e ndihmës shtetërore janë të detyruar deri më 28 shkurt të dorëzojnë raport deri te Drejtoria për zonat e lira ekonomike për ndarjen e ndihmës shtetërore. Drejtoria udhëheq evidencë dhe të dhënat ia dorëzon Komisionit për mbrojtje të konkurrencës. Me ndryshimin e serishëm dhe plotësimin e ligjit shpërndarësi i ndihmave shtetërore këtë informacion së pari ia dorëzon Agjencisë për investime të huaja, e më pas informacionin ia dorëzon Parlamentit të Maqedonisë dhe DZHZTI-së. Për këto të dhëna gjithashtu u dorëzua kërkesë për qasje deri të informata me karakter publik të të gjitha institucionet përkatëse por nuk morëm asnjë përgjigje.

Harxhimet për rregullimin dhe ndërtimin e zonave

Këto të dhëna janë nxjerr nga Buxheti i RM-së. Deri në vitin 2009 këto harxhime janë pjesë e të dalave të buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë në paragrafin D5, tërheqja

e investimeve të huaja direkte në zonat e lira ekonomike (Буџет на РМ, 2006, 2007, 2008), ndërsa pas vitit 2009 janë pjesë e buxhetit të DZHZTI-së në programin DV-zhvillimi i zonave teknologjike industriale (Буџет на РМ, 2008-2016). Deri më tani janë rregulluar dhe ndërtuar gjithsej 6 zona dhe at:

1. DZHZTI Shkup 1
DZHZTI Shkup 1 ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 140 hektarë.
2. DZHZTI Shkup 2
DZHZTI Shkup 2 ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 95 hektarë
3. DZHZTI Shtip
DZHZTI Shtip ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 208140 hektarë.
4. DZHZTI Struga
DZHZTI Struga ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 30 hektarë
5. DZHZTI Tetovë
DZHZTI Tetovë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 94.74 hektarë.
6. DZHZTI Prilep
DZHZTI Prilep ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 100 hektarë

Planifikohen edhe 5 DZHZTI dhe at në:

1. DZHZTI Gjevgjeli
2. DZHZTI Kërçovë
3. DZHZTI Strumicë
4. DZHZTI Rankovce
5. DZHZTI Radovish

Deri tani DZHZTI-të kanë realizuar disa furnizime publike për rregullimin e këtyre zonave të planifikuara megjithatë pritet vlera më të lartë e harxhimeve se sa janë të parapara për rregullimin dhe ndërtimin e këtyre zonave gjatë viteve të ardhshme.

Gjithashtu në analizë është përfshirë edhe e dhëna për harxhimet për rregullimin e zonës industriale (ZI) 'Zhaben' në Manastir. Për rregullimin e kësaj zone e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 86 hektarëve, pushteti lokal ka harxhuar 3.278.688 euro (Митрески, 2013). Njëherit janë ndarë mjete plotësuese për këtë zonë për ndërtimin e largpërçuesit në gjatësi prej 5,5 kilometra që paraqesin harxhime plotësuese.

Për periudhën 2008 – 2014 për çdo vit është llogaritur se sa është pjesëmarrja mesatare e harxhimeve buxhetore për rregullimin, ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre zonave të lira industriale në nominalen e BDB-së. Vlera e projektuar e BDB-së për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 është sipas shkallës së rritje të Fondit Monetar Ndërkombëtar

dhe është shumëzuar e me mesataren e përqindjes së DZHZTI në BDB-në dhe kështu është fituar se sa ka qenë për një viti vlera e buxhetit të kësaj drejtorie.

Humbja e të ardhurave në bazë të lirimit nga pagesat e tatimit të fitimit për periudhë prej 10 viteve për IHD në DZHZTI-të dhe zonat industriale “Zhaben” dhe “Telot”

Tatimi i fitimit është tatim i cili sipas Ligjit për tatim të fitimit është 10 për qind dhe paguhet në bazë tatimore që fitohet si rezultat i të hyrave të përgjithshme të zvogëluara për harxhimet totale. Në nenin 5 të Ligjit për zhvillimin e zonave teknologjike industriale i vitit 2007 parashihen lehtësime dhe lirime nga pagesa e tatimit të fitimit. Në ueb faqen e DZHZTI-së dhe Drejtorisë për të ardhura publike qëndron se kompanitë në zona lirohen nga pagesa e tatimit të fitimit për periudhë 10 vjeçare nëse në afat prej dy viteve pas marrjes së vendimit për fillimin me punë sipas kushteve të paraparë me ligj e fillojnë veprimtarinë në zonat.(DZHZTI dhe DAP). Pas realizimit të analizës u konstatua se të gjitha kompanitë e huaja të liruara nga tatim fitimi kanë filluar me punë.

Për llogaritjen e lirimit nga mos pagesa e tatim fitimit për periudhën 2006 – 2014 janë marrë nga Regjistri Qendror i RM-së. Janë shqyrtuar paragrafi 3 i tatim fitimit dhe paragrafi 4 i neto fitimit vjetor ku qartë shihet se kompanitë sa kanë paguar në emër të tatimit të fitimit për vitin rrjedhës. Nëse kanë paguar vlera të ndryshme nga ajo që parashihet me ligj prej 10 për qind atëherë merret vlera neto. Llogaritjet me thyesën $\{(neto-fitimi për vitin rrjedhës * 0,1) - pagesa e e tatimit të fitimit\}$.

Projektimet për periudhën 2015 – 2020 janë llogaritur në këtë mënyrë: duke pasur parasysh neto- eksportin e projektuar, të cilën e përdorëm që të vijmë deri të fitimi / humbja para se të tatimoheshin për çdo vit, përfundimisht me vitin 2014. E para për neto- eksport $\{të hyrat totale - (harxhimet totale - harxhimet për të punësuarit\}$ i shtuam edhe harxhimet për të punësuarit për raportet financiare dhe arritëm deri të përfundimi. Më pas u projektuan dhe harxhimet për një punëtorë për periudhën 2006-2014, ku u fitua si harxhim total për të punësuarit / numri i përgjithshëm i të punësuarve. Të dhënat janë siguruar nga raportet financiare të kompanive.

Për llogaritja e radhës është bërë për harxhimet për të punësuarit për periudhën 2015-2020. Kjo llogaritje është projektuar sipas numrit të punësuarve për vitin rrjedhës X dhe harxhimeve mesatare për 1 të punësuar për periudhën 2006-2014. Pastaj këtij harxhim të projektuar iu shtua dhe neto-eksporti për çka u fitua fitimi/humbja bazë para se të tatimoheshin, për periudhën 2015-2020. Shuma e fituar më pas u shumëzua me koeficientin 0,1 dhe u fitua projektimi i lirimeve tatimore.

Është e rëndësishme të thuhet se nga viti 2006 deri në vitin 2009, firmat prezent në zonat e lira ekonomike punojnë me humbje dhe për këtë periudhë shteti nuk a humbur të ardhura nga lirimi i tatimeve të këtyre firmave nga tatim fitimi.

Humbja e të hyrave si pasojë e lirimit të pagesave të tatimit personal dhe tatimit të fitimit për periudhë 10 vjeçare për të punësuarit në kompanitë e huaja në zonat e lira ekonomike dhe zonave industriale “Zhaben” dhe “Telot”

Tatimi personal është tatim i cili sipas Ligjit për tatim personal paguhet 10 për qind nga përllogaritja e neto rrogës për tërë vitin. Nga raportet financiare të kompanive shihen pagesat totale të neto rrogave në nivel vjetor. Vlerën që kompanitë duhet ti ja paguanin shtetit por janë të liruar nga pagesa fitohet në shumëzimin e vlerës totale të neto rrogave të paguara ndër vite në të gjitha kompanitë në zona dhe koeficientit 0,1111, koeficient që përllogaritet kur për bazë merret vlera neto e rrogës. Në raportet financiare të bilancit të suksesshëm përfundimisht me vitin 2010, të dhënat për rrogën neto gjenden në paragrafin 1.2.1 rroga dhe kompensimet nga rrogat (neto), derisa për periudhën 2011-2014 gjendet në pjesën e të dalave nga punimet, paragrafi 12 b. Rrogat dhe kompensimet nga rrogat (neto). Në nenin 5 të Ligjit për zhvillimin e zonave teknologjike industriale të vitit 2007 parashihen lehtësime dhe lirime nga pagesa e tatimit personal në pajtim me ligjin për tatim personal. Në ueb faqen e DZHZTI-së dhe Drejtorisë për të ardhura publike qëndron se kompanitë në zona lirohen nga pagesa e tatimit të fitimit për periudhë 10 vjeçare (DZHZTI dhe DAP).

Projeksionet për punësime të reja janë bërë në pajtim me projeksionet e Qeverisë për periudhën 2014 – 2018 për punësimin e 10.000 punonjësve të rinj (Влада на РМ, 2014). Duke pasur parasysh se për vitin 2014 ka të punësuar 5.362 persona dhe faktit se në vitin 2015 dhe në vitin 2016 kemi krizë politike shifra për punësimin e 10.000 punonjësve të rinj do të merret për periudhën 2015-2019 dhe në dy vitet e para përqindja e punësimeve do të jetë 15 për qind dh 85 për qind në dy vitet e tjera sipas dinamikës së përcaktuar të rritjes së punësimeve. Për vitin 2020 do të parashihen edhe 3.800 punësime plotësuese që fitohet si mesatarja nga rritja e numrit të projektuar të punësimeve në dy vitet e mëparshme. Rritja e projektuar për numrin e punësimeve të reja merret si relevant duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e infrastrukturës rrugore është ndërtuar në pajtim me prognozimet e FMN-së.

Harxhimet e mundshme nga dhënie e tokës

Harxhimet e mundshme paraqesin shfrytëzim alternativ të tokës në zona. Shfrytëzimin alternativ të tokave në zona e shohim nga aspekti i prodhimeve bujqësore. Kjo paraqet lëshim potencial dhe humbja e mundësive për shfrytëzimin sa ma të mirë të tokës ku janë ndërtuar zona industriale.

Harxhimet e mundshme të tokës janë llogaritur në bazë të rendimenteve të prodhimeve bujqësore. Është llogaritur gruri si kulturë më e përhapur në rajon ku janë të vendosura zonat. Ky informacion u fitua në bazë të hulumtimeve të Entit shtetëror të Statistikës të RM-së për rendimentet vjetore të kësaj kulture bujqësore. Me pjesëtimin e vlerës totale me hapësirën e përgjithshme e shfrytëzuar për mbjellje të grurit e fitua mesatarja për 1 hektarë, shumë e cila aplikohet në hapësirat e zonave. Përkatësisht deri në vitin

2009 përdorej vlera oficiale e hapësirave në zonat e lira ekonomike „Shkupi 1“, „Shkupi 2“, „Shtip“, „Tetovë“ dhe zonat industriale „Zhaben“ ndërkaq nga viti 2010 janë shtuar edhe pesë zona të planifikuara dhe kjo shumë pastaj është aplikuar deri në vitin 2020. Hapësira e zonave të planifikuara është llogaritur si mesatarja e zonave të deritanishme.

PËRFITIMET

Rrogat e paguar të punësuarve be IHD

Kjo e dhënë është përdorur si përfitime të popullatës. Kjo e dhënë është e lidhur direkt me qëllimet e strategjisë për zvogëlimin e papunësisë dhe përmirësimin e standardit jetësor. Logjika dhe simbolika e paraqitjes së rrogave në analizën tonë është se rrija e punësimeve është shansi mirë i të papunëve të fitojnë të ardhura dhe në mënyrë indirekte do të kontribuonte në përmirësimin e standardit jetësor të këtyre njerëzve. Gjithashtu në mënyrë indirekt do të rritej fuqia blerëse e popullatës në Maqedoni kështu do të kishte përfitime edhe ekonomia e vendit. Përveç kësaj rrogat shihet dhe si përfitime për shtetin përmes tatimit të vlerës së shtuar (TVSH) për shkak të faktit se nëse këta të punësuar planifikojnë ti harxhojnë rrogat e tyre në mënyra indirekte paguhet edhe TVSH-ja për mallrat dhe shërbimet që ata i blejnë. Vlera është marrë nga raportet financiare të firmave që punojnë në zonat. Vlera është fituar me mbledhjen e rrogave të paguara për të punësuarit në zonat e lira ekonomike dhe zonat industriale „Zhaben“ dhe „Telot“.


Të dhënat për neto rrogat janë gjetur në raporte financiare të kompanive të dorëzuar në Regjistrin qendror të RM-së për vitet 2006 – 2010, paragrafi 1.2 për rrogat neto dhe kontributet dhe paragrafi 214 për rrogat dhe kontributet për rroga (neto) për vitet 2011 – 2014. Projektioni është në këtë mënyrë: është marrë rroga mesatare e paguar për punëtorë ndër vite për periudhën 2006 – 2014 dhe është përpjesëtuar me vlerën totale të rrogave neto të paguara me numrin e përgjithshme të punësuarve deri në këtë vit në zona. Projektimet nga viti 2015 – 2020 janë bërë ashtu që shuma e vitit 2014 është marrë si bazë sipas të cilës janë paguar të gjitha rrogat e të punësuarve në zona për këtë vit. Kësaj shume i është shtuar dhe numri i punësimeve të planifikuara për vitin 2015 dhe është shumëzuar me rrogën mesatare të korrigjuar me koeficientin për rritjen e rrogave që fitohet vlera e mesme nga rritja e rrogave në vitin rrjedhës kundrejt viteve për periudhën 2006 – 2014. Me këtë fitohet dhe projektioni për vitin 2015. Për vitin 2016 llogaritja bëhet sipas parimit të njëjtë, shuma bazë e vitit 2015 rritet me numrin e planifikuara të punësimeve për vitin 2016 shumëzohet me rrogën mesatare dhe koeficientin e rritjes. Edhe gjatë viteve të ardhme shkohet më të njëjtën logjikë të llogaritjes.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në kompanitë e huaja në vitin 2014 kap shifrën prej 9.576 persona. Neto rroga mesatare në këto 14 kompani në zonat e lira ekonomike është 21.653 denarë dhe është më e vogël se rroga mesatare neto në Maqedoni prej 22.407 denarë sa ishte në r muajin dhjetor të vitit 2014, publikuar nga ana e Entit

shtetëror të statistikës. Gjithashtu vlen të cekët se mesatarja e rrogave në këto firma mund të jetë nën ndikimin e rrogave të larta të menaxhereve. Në këto kompani koeficienti mesatar i rritjes së rrogave në nivel vjetor është 1,09 për qind. Nga viti 2006 e deri në vitin 2014 një punësim në zonat e lira shtetit i ka kushtuar 395.185 denarë ose 6.426 euro. Kjo e dhënë është fituar me krahasimin e numrit të punësuarve deri në vitin 2014 dhe dallimi i harxhimeve të përgjithshme nga realizimi i strategjisë deri në vitin 2014 dhe rrogat e paguara dhe kontributeve për sigurim social të punësuarve.

Grafiku 5:

Krahasimi i të punësuarve në zona me numrin e të papunëve në R.M.



Sipas grafikut 5, ndikimi punësimeve në vend nga IHD ka arritur kulminacionin në periudhën prej viti 2012 deri në vitin 2014. Vitet para 2011 nuk janë marrë parasysh për faktin se në këto zona funksiononte vetëm një kompani dhe niveli i pjesëmarrjes ishte shumë i vogël prej 1,68 për qind. Llogaritja është bërë duke krahasuar ndryshimet e papunësisë në nivel vjetor sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikës. Pasqyra e grafikut tregon se ndikimi i punësimeve në këto kompani është më se evidente krahasuar me zvogëlimin e papunësisë ndër vite. Në vitin 2012, punësimi në këto firma është 29,40 për qind krahasuar me zvogëlimin e përgjithshëm të numrit të papunëve për vitin e njëjtë. Në vitin 2013 dhe vitin 2014 ka qenë 16,01 për qind dhe 17,36 për qind. Kur kemi parasysh se këto 14 kompani kanë punësuar 9.576 njerëz deri në fund të vitit 2014, grafiku tregon se këto firma kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e papunësisë në vend.

Përmirësimi i bilancit tregtarë i shtetit si rezultat i IHD (neto)

Një ndër qëllimet e strategjisë për tërheqjen e investime të huaj direkte është që të rritet eksporti i Republikës së Maqedonisë i cili do kontribuonte në zvogëlimin e importit. Orientimi i firmave në zonat e lira ekonomike është eksporti prandaj është më


se e logjikshme që eksporti në vend të rritet. Të dhënat për neto eksport janë llogaritur përmes dallimeve të të ardhurave nga veprimtaria bazë e firmave me harxhimet totale (pa harxhimet për punëtorët). Llogaritja për rritjen e projektuar neto të eksportit është bërë në këtë mënyrë: për bazë nga e cila do të projektohet rritja është marrë mesatarja nga vitet kur ka pasur rritje pozitive të neto eksportit. Kjo bazë u vendos si projektion për vitin 2015. Pastaj baza është shumëzuar me koeficientin mesatar të rritjes dhe u fitua vlera e mesme nga koeficienti i rritjes për vitin rrjedhës krahasuar me vitin paraprak. Kështu u fitua projektioni për vitin 2016 e cila më tej u bë bazë për llogaritjen e projektionit për vitin 2017 në të njëjtën mënyrë si për vitin 2016. Kjo mënyrë e llogaritjes do të zbatohet edhe për vitet e tjera. Këtu duhet të thuhet se projektionet për vitin 2015, 2016 dhe 2017 mund ti ndërrojnë vendet ose të gjendet mesatarja për shkak të pasigurisë nga periudha kohore kur investimet e ardhshme do të fillojnë me punë. Si gjithë investimet e reja përfshirë dhe kompanitë të cilat disponojnë me të dhëna faktike në fillim të punës gjegjësisht vitet e para do të gjenerojnë neto efekte negative.

Në grafikun 6, pjesëmarrja e kompanive në vlerën e përgjithshme të eksportit të RM-së nga viti 2007 e deri në vitin 2014 mesatarisht është 11,57 për qind. Në vitet e para firmat më shumë rëndësi u kanë kushtuar investimeve se sa eksportit, gjë që është logjike për vitet kur ata filluan me punë. Është interesante se si rritej numri i firmave, këto firma tani më të stabilizuar filluan të shënojnë edhe rritje të eksportit në vitet e ardhshme. Në vitin 2014 eksporti i këtyre 14 kompanive ishte 31,87 për qind që tregon se po përmbushet qëllimi i strategjisë për rritje të eksportit. Pjesëmarrja është llogaritur përmes të hyrave të përgjithshme të kompanive krahasuar me eksportin e përgjithshëm në RM. Arsyet se pse janë marrë të ardhurat e përgjithshme të kompanive është për shkak se këto kompani janë të orientuar kah eksporti kështu që të hyrat që i realizojnë pjesa më e madhe i takojnë eksportit. Po ashtu sipas grafikut 7 mbulimi i eksportit kundrejt importit është rritur dhe në vitin 2014 dhe ky mbulim është më i lartë në periudhën e analizës dhe është 67,88 për qind. Nisur nga fakti se pjesëmarrja e këtyre kompanive në eksport në vitin 2014 është një e treta e eksportit të përgjithshëm të vendit rezultati i përmirësimit të mbulimit është pjesë e rezultateve të kompanive të reja në këto zona.


Harxhimet për sigurimet sociale

Për këtë llogaritje janë shfrytëzuar të dhënat nga raportet financiare të firmave në zonat e lira ekonomike. Në sigurimet sociale hyjnë harxhimet që këta firmat paguajnë sigurimet shëndetësore dhe sigurimet pensionale invalide të punësuarve. Të gjitha këto llogariten si përfitime për shtetin dhe popullatën. Arsyeja është e thjeshtë se nëse nuk do të ishin investimet e huaja direkte një pjesë e këtyre punëtorëve nuk do të punonin dhe harxhimet sociale do të binin në kurriz të shtetit dhe shteti do të kishte për obligim të ua paguan sigurimin shëndetësor dhe sigurimin pensional dhe invalidor. Sigurimi pensional është përfitim për të punësuarit për shkak se punojnë dhe këta perona kanë shanse të marrin pensionin kur të mbushin stazhin përndryshe nëse këta njerëz nuk do të punonin nuk do të kishin shans të fitojnë pensionin.

Grafiku 6:
Pjesëmarrja në eksporti e kompanive në zonat



Grafiku 7:
Mbulimi i importit me eksport



*Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (2016)


Të dhënat për periudhën 2006 – 2010 gjenden në paragrafin 1.2.2 harxhime tatimore, sigurimi social dhe sigurimi pensional për periudhën 2011 – 2014 dhe në paragrafin 216 kontribute nga sigurimi pensional i detyrueshëm. Llogaritja është bërë në këtë mënyrë: E para me pjesëtimin e vlerës së përgjithshme të kontributeve të paguara përgjatë vitit me numrin e të punësuarve për të njëtin vit dhe u bë llogaritja se sa është pagesa për një të punësuar brenda një viti. Pastaj u llogarit mesatarja se sa është pagesa e kontributeve të punëtorë në nivel vjetor për periudhën 2006 – 2014.

Zhvillim i barabartë rajonal përmes bashkëpunimit të IHD me kompanitë vendore

Si përfitime tjera nga politikat e IHD janë edhe përfitimet që i kanë kompanitë vendore në bazë të bashkëpunimit që i kanë kompanitë vendore më firmat e huaja (ndërtimin e objekteve, ushqim, repromateriale, mirëmbajtje etj.). Në mungesë të dhënave zyrtare në analizën janë paraqitur shumata e përafërta që dalin nga bashkëpunimi. Metodologjia e llogaritjes është sipas raporteve financiare të kompanive në zona. Është marrë paragrafi detyrimet ndaj furnizuesve. Nga shumata e përgjithshme si vlerësim konservativ është marrë 10 përqindëshi, vlerësojmë se kjo për qindje u takon kompanive maqedonase. Patjetër duhet të themi se shumata e detyrueshme e kompanive është shumata që kompanitë u kanë mbetur borxh furnizuesve deri në fund të vitit 31.12 që kompanitë maqedonase e kanë realizuar. Janë përjashtuar prodhimet dhe shërbimet që janë realizuar dt cilat janë paguar në të njëjtin vit prandaj mund të themi se kjo është shumata minimale që është fituar.

Gjatë periudhës prej vitit 2006 deri në fund të vitit 2014, sipas supozimeve tona përfitimi i përgjithshëm është 2.674.424.434 denarë. Sipas grafikut 8 shihet qartë se në pesë vitet e para bashkëpunimi në tërësi ka qenë më kompanitë vendore në rajonin e Shkupit. Vitet e tjera ashtu si rritej numri i kompanive vendore punonin në zonat e tjera rajonale është më së e qartë se bashkëpunimi gradualisht ka filluar të zgjerohet dhe të ritet edhe në rajonet tjera.

Grafiku 8:
Pjesëmarrja e bashkëpunimit me rajonet




Sa i përket ndikimeve që këto kompani e kanë në ekonominë e Maqedonisë, grafiku 9 tregon se të hyrat e firmave kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të BDB-së. Në vitin 2014 kjo pjesëmarrje në BDB-në ka qenë 13,88 për qind që njëherit është tregues i mirë se të hyrat e këtyre firmave ndikojnë pozitivisht në Bruto Prodhimin e Brendshëm.

Gjithashtu duhet të cekim edhe bashkëpunimin e shtetit gjegjësisht DZHZTI me kompanitë vendore. Harxhimet për rregullimin e ZZHTI dhe DZZHTI-së vetëm se janë llogaritur në kalkulatorin tonë, kështu që këtë përfitim e vlerësojmë si përfitim indirekt dhe si një informacion plotësues për ndikimin tek kompanitë vendore nga programi për tërheqjen e IHD-vë. Përfitimi vlerësohet si pjesë e ndikimit në rritjen ekonomike dhe zhvillimin rajonal të vendit. Ky ndikim është matur nga të dhënat për publikim e shpalljeve për furnizime publike. Bashkëpunimi i përgjithshëm i Drejtorisë së zonave të lira ekonomike dhe i kompanive vendore nga viti 2013 deri në vitin 2016 ka arritur shifrën prej 768.310.268 denarë së bashku me TVSH-në.

Grafiku 9:

Pjesëmarrja e të hyrave të përgjithshme të firmave në zonat në BDB



Transmetimi i njohurive dhe progresi teknologjik

Ky lloj përfitime vlerësohet si përfitim indirekt për ekonominë e vendit dhe njëherit si përfitim edhe për kompanitë vendore dhe të punësuarit në zona. Progresi teknologjik dhe ndikimi që kanë IHD luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e punës dhe diturive për punëtorët e tyre në Maqedoni. Kur kemi parasysh se IHD sjellin teknologji të re dhe mënyra të reja të punës në vlerësojmë se në mënyrë indirekte e gjithë kjo ndikon në përmirësimin e punës të firmave vendore që bashkëpunojnë me firmat e huaja në zona. Gjithashtu si përfitim do të llogaritet edhe trajnimet e të punësuarve në këto firma nga dhe fitojnë aftësi dhe njohuri të reja në për punën që ata e bëjnë. Transmetimin e njohurive e shohim përmes faktit se kompanitë vendore bashkëpunojnë me kompanitë e huaja dhe më vonë do të zbatojnë praktikatat e reja të punës (teknologji të re, mënyra të reja të punës dhe strategji të re punuese). Po ashtu trajnimet që i organizojnë firmat e huaja për punëtorët e tyre në mënyrë indirekte do të ndikonin në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të këtyre njerëzve. Progresi teknologjik llogaritet sipas

metodës growth accounting, dhe i analizon faktorët e ndryshëm që ndikojnë në rritjen ekonomike (rritje të BDB-së). Në analizën tonë i përdorëm të dhënat nga hulumtimi i Lazarovit dhe Petreskit (Lazarov and Petreski, 2015) dhe në këtë hulumtim rezultoi se në Maqedoni progresi teknologjik merr pjesë me 8.5 për qind në shkallën mesatare të BDB-së. Sipas kësaj analize jonë në radhë të parë shqyrton dallimin e BDB-së nga viti në vit, dhe merret 8,5 përqindëshi që e përcakton progresin e përgjithshëm teknologjik të vendit. Sipas kësaj ndikim që kanë IHD-së në progresin teknologjik arrihet përmes llogaritjes së pjesëmarrjes të tyre në BDB e përgjithshëm ndër vite. Kjo pjesëmarrje merret nga progresi i përgjithshëm teknologjik dhe fitohet vetëm vlera e progresit teknologjik i cili është nën ndikim të këtyre firmave. Projektionet e tyre në BDB-në e përgjithshme të vendit. Kjo pjesëmarrje mesatare krahasohet edhe për vitet e projektuara me vetë faktin se projektionet e BDB-së për vitet e ardhshme tani më veç janë bërë sipas të dhënave të FMN-së dhe të hyrat e tyre ndër vite të cilat proporcionalisht janë rritur në vlerë absolute. Arsytet e llogaritjes së kësaj është për shkak se ne nuk mundemi të supozojmë se si do të jetë suksesi i këtyre firmave gjatë viteve të ardhshme prandaj llogaritet e bëmë nga aspekti konservativ me pjesëmarrje mesatare.

REZULTATET

Rezultatet nga analiza për harxhimet dhe për përfitimet janë paraqitur përmes kalkulatorit në „exel“. Mënyra e llogaritjes është sipas Doracakut për analizimin e harxhimeve dhe përfitimeve të Komisionit Evropian (European Commission, 2014):

Pasi të llogaritet harxhimet totale dhe përfitimet nga strategjia në nivel vjetor, llogariten dhe ndryshimet e tyre. Ndryshimet e neto efekteve ndër vite llogariten me faktorin diskont e cila në analizën tonë është e përcaktuar në 8,90 për qind. Neto vlera e tanishme është tregues se sa është neto efekti (në denarë) të një programi apo strategjie sipas vitit kur dhe u realizua kjo analizë.

Përllogaritja e përqindjes prej të faktorit diskont është sipas Doracakut të Komisionit Evropian (2014) në të cilin sugjerohet se në përgjithësi llogaritje e përdorur është se faktori diskont të jetë sipas shkallës të obligacioneve shtetërore të vendit në të cilin po zbatohet programi ose strategjia. Ne bëjmë kombinim konservativ të shkallës së obligacioneve shtetërore me afat kthimi prej 10 vite dhe shkallës së rrezikut të vendit. Shkalla e obligacioneve shtetërore është 3,50 në 22.12.2015 dhe 5,40 për qind Premium rreziku sipas shkollës „Stern Biznesi“ nga Nju Jorku. Shkalla e tatimpaguesve shtetëror merret si instrument i pa rrezikshëm që e emeton Ministria e Financave e RM-së dhe garancisë se detyrimet e këtij instrumenti do të paguhet kreditorit që e ka këtë instrument. Premium rreziku i vendit është sipas analizës së rejtingut kreditorë, situatës politike, valutës stabile dhe huazimeve të një vendi. Ky rrezik paraqet vlerën

minimale të parave që investitorët e huaj në një shtet e presin si kthim të investimeve për rrezikut që e pranojnë për të investuar.

Në këtë analizë janë përfshirë 14 investitorët e huaj që janë prezentë në zonat: „Visteon elektroniks Maqedoni “ sh.p.k.p.i (Shkup), „Van Hol“ sh.p.k.p.i (Ilinden), „Drekslmajer“ sh.p.k.p.i. (Kavadar), „Xhonson meti “ sh.p.k.p.i. (Bunarxhik), „Vitek“ sh.p.k. (Ilinden), „Krombert dhe Shubert“ sh.p.k.p.i. (Manastirë), „Xhonson Kontrolls“ sh.p.k.p.i (Shtip), „Kemet elektroniks“ sh.p.k.p.i (Shkup), „Istem medikal“ sh.p.k. (Ilinden), „Prodis“ sh.p.k. (Ilinden), „Makdija“ sh.p.k.p.i (Ilinden), „Pro kompo adventixh tehnoloxhis “ sh.p.k.p.i (Jegunocë) „AR automotiv Maqedoni“ (Ilinden) dhe „Makdija“ sh.p.k.p.i (Shkup).

Në bazë të informatave të fituara vlera e përgjithshme e neto vlerës së tanishme nga viti 2006 e deri në vitin 2020 është 35.064.658.992 derrarë. Kjo tregon se përfitimet nga strategjia dukshëm i tejkalojnë harxhimet për realizimin e kësaj strategjie. Me qëllim që të shihet lartësia relative e neto efekteve nga politikat e investimeve të huaja direkte nevojitet që vlera e tanishme të vendoset në proporcion me lartësinë e ekonomisë maqedone, që do të thotë lartësia e bruto prodhimit të brendshëm. Prandaj së pari është llogaritur vlera e tanishme nominale e Bruto Prodhimit të Brendshëm për periudhën 15 vjeçare 2006 - 2020 e cila diskontohet me shkallën e njëjtë të diskontit si dhe neto efektet nga investimet e huaja në të vitit 2006. Kështu fitohet vlera e tanishme nominale e BDB-së prej 4.179.813.458.000 denarë. Nëse neto vlera e tanishme e efekteve nga politikat për IHD vendosen në proporcion me vlerën e tanishme të BDB-së fitohet përqindja prej 0,84. Pra neto efektet akumuluese nga politikat e IHD-së për periudhë 15 vjeçare të diskontuara në vitin 2006 janë nën 1 për qind nga vlera akumuluese e BDB-së nominale për periudhën e njëjtë (e diskontuar në vitin 2006). Përmes krahasimeve të harxhimeve dhe përfitimeve nga strategjia mund të llogaritet se sa përfitime sjell projekti për çdo denarë të harxhuar. Kjo vlerë fitohet sipas shumës së përfitimeve totale gjatë kësaj periudhe dhe harxhimeve totale për periudhën e njëjtë. Rezultatet e analizës sonë tregojnë se proporcioni është 1 : 5,38 që tregon se për çdo denarë të harxhuar për këtë strategji shteti ka përfituar 5,38 denarë. Gjithashtu sipas tabelës 1, harxhimet që ndikojnë më së shumti mbi këtë strategji janë harxhimet për zhvillim të zonave të lira ekonomike dhe humbjet në buxhetin e Agjencisë për investimeve nga të hyrat e tatimit personal. Në anën e përfitimeve kjo strategji ka më shumë përfitime nga neto eksporti i këtyre firmave se sa pagesave të rrogave dhe progresit teknologjik.

Në Analizën tonë është aplikuar edhe analiza e sensitivitetit të paragrafëve në kalkulim. Kjo analizë e sensitivitetit paraqet skenar pesimiste dhe optimiste me dhënien e vlera të ndryshme për harxhimet dhe përfitimet për periudhën nga viti 2015 e deri në vitin 2020. Tabela 1 paraqet skenari tonë bazë përmes të cilit kemi analizuar skenarin optimist dhe pesimist. Skenari pesimistë është se harxhimet për këtë periudhë të caktuar janë më të larta për 5 për qind nga supozimet tona në skenarin bazë. Vlera neto e tanishme e këtij skenari është 34.845.235.331 denarë që është për 219.423.661 më i ulët se skenari bazë. Kjo tregon se ndikimi i harxhimeve kundrejt përfitimeve është i vogël edhe sikur këto harxhime për këtë periudhë do të rriteshin 100 për qind që do

INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Tabela 1. Kalkulator ia analizës për harxhimet dhe përfitimet

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Harxhime							
Lloji 1 - Materiale direkte							
Shpenzime për funksionimin e Agjencisë për të heqjen e investimeve të huaja direkte dhe promovimin e eksportit të RM (AITHDPRERM)		271.190.000	265.000.000	186.759.000	344.454.000	301.577.000	351.560.000
Shpenzimet për zhvillimin e zonave teknologjike industriale (DZHZTI)				38.086.000	59.524.000	89.402.000	104.714.000
Shpenzimet për zhvillimin e zonave	48.027.000	393.870.000	672.753.000	471.967.000	308.500.000	295.300.000	320.500.000
Lirimi nga pagesa e tatimit fitimit për periudhë 10 vjeçare për IHD në zonat					8.155.601	125.497.863	193.594.766
Humbja e të hyrave nga lirimi i pagesave për tatimin personal për periudhë 10 vjeçare		410.378	2.605.826	5.884.854	12.257.977	20.277.147	32.066.723
Harxhime të op	6.011.814	23.091.376	26.784.347	23.091.376	46.210.480	46.210.480	46.210.480
Shpenzimet totale	54.038.814	688.561.753	967.143.173	725.788.230	779.102.057	878.264.489	1.048.645.969

Benefitet							
Lloji 1 - Materiale direkte							
Pagesat e rrogave të punëtorëve në zona		3.693.768	23.454.783	52.968.981	110.332.823	182.512.573	288.629.371
Përmirësimi i bilansit tregtar i shtetit si rezultat i IHD (neto-eksport)		-72.938.037	-229.924.086	-182.377.038	-2.110.204.623	1.859.910.929	4.523.799.734
Pagesa e përgjithshme e kontributeve për sigurim social		2.310.688	13.030.080	23.477.890	49.194.350	70.125.922	99.237.917
Progresi teknologjik know-how		150	29.117.559	-725.976	429.402.604	1.549.292.710	182.768.343
Zhvillimi rajonal	16.663	46.994.105	84.847.303	1.480.445.631	133.528.450	136.341.223	187.460.520
Benefitet totale	16.663	-19.939.326	-79.474.361	1.373.789.489	-1.387.746.396	3.798.183.357	5.281.895.885

Neto (Benefite+Shpenzime)	-54.022.151	-708.501.080	-1.046.617.534	648.001.259	-2.166.848.453	2.919.918.868	4.233.249.916
----------------------------------	--------------------	---------------------	-----------------------	--------------------	-----------------------	----------------------	----------------------

Vlera neto e tanishme (Diskonte)	-54.022.151	-650.403.991	-882.298.581	501.552.975	-1.540.629.250	1.903.787.102	2.535.716.700
---	--------------------	---------------------	---------------------	--------------------	-----------------------	----------------------	----------------------

Shkalla diskonte (8.90%)		0,918	0,843	0,774	0,711	0,652	0,599
---------------------------------	--	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------

Vlera e tanishme neto totale (15 vite) 35.064.658.992

Analiza për shpenzimet dhe përfitimet nga politika për tërheqjen dhe
 rritjen e investimeve të huaja direkte në Republikën e Maqedonisë

2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
421.035.000	563.650.000	489.776.000	448.555.000	426.966.291	441.483.145	457.376.538	474.756.846
144.938.000	153.405.000	304.180.000	305.694.000	120.945.649	125.057.801	129.559.882	134.483.157
431.000.000	453.700.000	533.250.000	853.682.000	465.963.496	481.806.255	499.151.280	518.119.029
217.976.116	379.549.607	407.396.414	403.674.072	318.389.519	347.090.494	345.765.535	357.201.165
83.494.239	207.036.295	228.694.496	251.246.355	282.531.369	317.417.916	357.316.589	402.455.524
46.210.480	46.210.480	46.210.480	46.210.480	46.210.480	46.210.480	46.210.480	46.210.480
1.344.653.835	1.803.551.382	2.009.507.389	2.309.061.907	1.661.006.803	1.759.066.091	1.835.380.304	1.933.226.201
751.523.305	1.863.513.006	2.058.466.305	2.261.443.340	2.543.036.621	2.857.046.952	3.216.170.914	3.622.461.959
3.986.705.486	7.623.359.938	4.498.444.022	4.885.700.480	5.306.294.592	5.763.096.286	6.259.222.557	6.798.058.730
295.972.482	675.471.719	948.176.173	1.042.278.611	376.409.755	1.531.611.293	1.842.149.341	2.199.738.608
3.217.346.233	3.294.615.327	1.306.565.536	1.458.124.651	1.574.126.910	1.697.798.936	1.880.062.893	2.075.475.588
255.225.091	349.565.449	478.644.360	655.386.349	897.391.263	1.228.757.785	1.682.483.167	2.303.749.073
8.506.772.596	13.806.525.438	9.290.296.395	10.302.933.431	10.697.259.140	13.078.311.251	14.880.088.872	16.999.483.957
7.162.118.761	12.002.974.056	7.280.789.006	7.993.871.524	9.036.252.337	11.319.245.161	13.044.708.569	15.066.257.756
3.939.165.319	6.061.501.898	3.378.286.099	3.405.389.269	3.533.174.664	4.063.609.013	4.304.753.828	4.565.076.100
0,55	0,505	0,464	0,426	0,391	0,359	0,33	0,303

te thotë se vlera neto e tanishme është pozitive. Përfundimi i këtillë u përcaktua kur u shqyrtua skenari optimist. Në këtë skenar harxhimet janë të njëjta por përfitimet për këtë periudhë të caktuar janë rritur për 5 për qind. Ndikimi i tanishëm i vlerës neto është më e lartë dhe at 36.446.597.102 denarë apo 1.381.938.110 denarë më shumë. Gjithashtu nëse përfitimet do të uleshin për 99 për qind neto vlera e tanishme do të ishte prapë pozitive. Parashikimi prej 5 për qind merret si parashikim konservativ në llogaritjet tona edhe pse për analizimin e sensitivitetit nevojiten më shumë variante dhe llogaritje të ndikimeve prandaj ne vlerësojmë se kjo analizë tregon për ndikimet që kanë përfitimet nga strategjia kundrejt harxhimeve.

Shkalla jonë interne e rentabilitetit është 68 për qind dhe është më e lartë se shkalla diskonte e shfrytëzuar prej 8,9 për qind. Ndryshe shkalla interne e rentabilitetit paraqitur e barazon vlerën e përgjithshme neto të investimeve me investimet e para e cila është aplikuar për këtë strategji, gjegjësisht kur dallimi i tanishëm i neto vlerës së përgjithshme të investimeve me investimet e para është zero. Vlerësimi i strategjisë me ndihmën e kritereve të shkallës interne të rentabilitetit është nxjerr sipas madhësisë së shkallës interne të rentabilitetit. Nëse shkalla interne e rentabilitetit është më e madhe nga shkalla diskonte e miratuar atëherë kjo politike, programi vlerësohet si e vlefshme dhe ekonomisht e arsyeshme për tu realizuar. Në rastin tonë shkalla interne e rentabilitetit është 68 për qind që tregon se kjo strategji për tërheqjen e investimeve të huaja direkte është e arsyeshme.

Sipas grafikut 10 vërehet se ndihma shtetërore është me e madhe në vitin 2014 ndërkaq është e planifikuar që në vitin 2016 të jetë 466 milion denarë. Kjo vlerë veç se ishte vendosur në kalkulatorin tonë nga Buxheti i RM-së por duhet të tregojmë se kjo tendencë dhe vlera kaq e madhe është problematike.

Informatat janë siguruar nga programi qeveritar për zhvillim ekonomik përmes së cilës realizohet nën programi për përkrahjen e investimeve të huaja e cila realizohet përmes Agjencisë për investime të huaja. Sipas buxhetit për vitin 2015 në paragrafin 3 – pjesa zhvillimore e buxhetit, në kuadër të këtij nën programi janë përfshirë aktivitete në bazë të marrëveshjeve të kontraktuara për dhënien e ndihmave shtetërore shfrytëzuesve në zonat e lira ekonomike të cilat i ka kontraktuar agjencia pas marrjes së autorizimit nga Qeveria e RM-s, në formë të granteve për hapjen e vendeve të reja të punës si dhe grante për ndërtimin e objekteve. Paraprakisht sqarimi i këtij nën programi paraqitet edhe te komponenti zhvillimorë në Buxhetin e vitit 2010 ku thuhet se këto mjete janë ndihma shtetërore që shkojnë për trajnimin dhe aftësimin e punëtorëve të rinj, ndërtimin e objekteve ndërtimore. lirim të kompensimit për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore dhe lehtësime tjera që parashihen në Ligjin për zona të lira ekonomike. Kjo kategori viteve tjera paraqitet edhe në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë si nën program për zhvillim ekonomik (Буджет на РМ, 2007 – 2015). Nisur nga ky fakt se përmes këtij nën programi ndahen grante për çdo vit nga buxhetet është marrë kategoria subvencionim dhe transfere, e cila paraqitet si kategori nën programore për investime. Me këtë vlera totale e subvencioneve si grante për kompanitë e huaja në vend është 1.800.680.000 denarë.

Grafiku 10:
Ndhimja shtetërore



*Buxheti i RM-së (2007 – 2016)

PËRFUNDIM

Sipas rezultateve të analizës për harxhimet dhe përfitimet mund të thuhet se kjo strategji ofron më shumë përfitime se sa harxhime. Me vet faktin se për 1 denarë të harxhuar nga kjo strategji shteti ka rikthyer 5,38 denarë që tregon qartë se strategjia sipas analizave tona jep rezultate pozitive.

Këto kompani gjithashtu kanë ndikim të madh në eksport. Pjesëmarrja prej 31.87 përqind në eksportin total të Republikës së Maqedonisë dhe përmirësimin e mbulimit të eksportit lidhur me importet tregon se LHD ndikojnë pozitivisht në eksportin. Gjithashtu bashkëpunimi më firmat vendore deri në një shkallë ka ndikim pozitiv në zhvillimin rajonal dhe progresit teknologjik në ekonominë e Maqedonisë.

Sipas të dhënave nga grafiku 5, pjesëmarrja totale e të punësuarve në Zonat e lira ekonomike dukshëm është rritur në periudhën prej vitit 2012 deri në vitin 2014. Kjo njëherit tregon se këta kompani të huaja kanë luajtur rol pozitiv në zvogëlimin e papunësisë.

Përfitimet e popullatës lidhur me punësimet janë se të punësuarit kanë shansin të kenë sigurimet sociale dhe shëndetësore ndërkaq ekonomia ka përfitime me rritjen e konsumit dhe TVSH-së, që janë të hyra të shtetit nga shërbimet që ata i blejnë.

Duhet të pranojmë se analiza jonë është mbështetur në faktet kuantitative dhe të dhënat e siguruara nga burimet përkatëse nga institucionet shtetërore përkatëse mirëpo u ballafaquam me probleme serioze kur donim të sigurojmë informata më të sakta dhe më të detajuara. Edhe pse të dhënat tona janë të përshtatshme nuk mund të garantojmë se janë të gjitha të vërteta. Njëra nga arsyt është se kemi shfrytëzuar të dhëna nga Buxheti i RM-së e jo nga raportet financiare të përfunduara. Raportet financiare përfundimtare tregojnë të dhëna më të sakta lidhur me faktin se sa harxhime

janë realizuar nga buxheti i planifikuar. Arsyeja e dytë është se kur kontaktonim me organet kompetente me kërkesë për qasje deri te informatat me karakter publik asnjëri nga këto organe nuk na dhanë informatat të cilat ne i kërkonim. Sipas nenit 21 të Ligjit për qasje deri të informatat me karakter publik nga dita e dorëzimit të kërkesës skadoi afati prej 30 ditëve sa parashihet që institucionet të kthejnë përgjigje dhe ne analizën e përfunduar pa këto të dhëna zyrtare.

Po ashtu duhet të cekim se llogaritë tona janë të supozuara dhe mund të ndryshohen kur kemi parasysh faktin se jemi udhëhequr nga supozimet konzervative të cilat deri në një shkallë janë të sakta dhe vlerësojmë se analiza jonë në përgjithësi ka përfshirë ndikim e strategjisë mbi vendin.

REKOMANDIME

- Nevojitet institucion shtetëror përkatës që do të azhurnon dhe krijon analiza për harxhimet dhe përfitimet që dalin nga programi në nivel vjetor. Një praktik e këfillë do t'ju mundëson organeve kompetente që kanë për synim të tërheqin investime të huaj dhe të bashkëpunojnë me investitorët e huaj kështu do të mund të arrijnë qëllimin për përmirësimin e programit në nivel vjetor.
- Sqarime jo të mjaftueshme për programet dhe zërave të Buxhetit dhe mos pasur interes të mjaftueshëm që të ofrohen më shumë informacione për të dhënat edhe kur dorëzohen kërkesa për qasje deri të informatat me karakter publik, seriozisht i bënë edhe me pak harxhimet fiskale në vend. Në interes të shtetit dhe popullit është që organet kompetente të jenë më të hapur në sqarimin se si realizohen programet. Gjithashtu vlen të përmendet se ka nevojë më të madhe për transparencë buxhetore sa i përket sqarimeve të zërave në Buxhet dhe institucionet në vazhdimësi duhet të publikojnë raportet financiare vjetore. Kjo praktikë do të ndikonte në përmirësimin e analizave ekonomike të organizatave dhe informimin sa më të saktë të qytetarëve në vend.
- Institucionet shtetërore patjetër duhet të japin llogaridhënie për realizimin e programeve dhe të jenë të përgatitur që të bënë ndryshime në programet nëse këto programe nuk i plotësojnë efektet e parapara.
- Është më se e nevojshme të analizohen të gjitha të dhënat lidhur me Investimet e huaja direkte në vend. Qasja deri të këto të dhëna dhe informatave do të kontribuojnë në përmirësimin e efekteve ekonomike nga investimet e huaja direkte për vendin. Informatat më të detajuara siç janë eksporti i kompanive në zonat, vlera e bashkëpunimit midis kompanive vendore me kompanitë e huaja si dhe informata lidhur me numrin e të punësuarve dhe rrogave qa jepen nga këto firma do të ishin informata shumë të rëndësishme për shtetin dhe opinionin.
- Nevojiten sqarime më të sakta për buxhetin e Agjencisë për investime të huaj dhe promovim të eksportit dhe Drejtorisë të zonave të lira ekonomike. Me vetë faktin se shumë zona janë të ndërtuara dhe se 14 kompani punojnë dhe

prodhojnë efekte pozitive shtrohet pyetja se pse buxheti i këtyre institucioneve ne vazhdimësi ka harxhime më shumë buxhet se buxheti i paraparë për harxhime dhe për përfitime për tërheqjen e investimeve të huaja. Nevojitet që institucionet e involvuara të realizojnë nevojat dhe vlerën e planifikuar të parave për efikasitet sa më të mirë për realizimin e strategjisë për tërheqjen e investimeve të huaja.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Влада на Република Македонија (2014) *Програма на Владата на Република Македонија 2014 – 2018*.
- [2] Државен завод за ревизија на Република Македонија (2009) *Агенција за странски инвестиции на Република Македонија - конечен извештај на овластенои државен ревизор*.
- [3] Министерство за финансии на Република Македонија (2006) *Буџет на Република Македонија за 2006 година*.
- [4] Министерство за финансии на Република Македонија (2007) *Буџет на Република Македонија за 2007 година*.
- [5] Министерство за финансии на Република Македонија (2008) *Буџет на Република Македонија за 2008 година*.
- [6] Министерство за финансии на Република Македонија (2009) *Буџет на Република Македонија за 2009 година*.
- [7] Министерство за финансии на Република Македонија (2010) *Буџет на Република Македонија за 2010 година*.
- [8] Министерство за финансии на Република Македонија (2011) *Буџет на Република Македонија за 2011 година*.
- [9] Министерство за финансии на Република Македонија (2012) *Буџет на Република Македонија за 2012 година*.
- [10] Министерство за финансии на Република Македонија (2013) *Буџет на Република Македонија за 2013 година*.
- [11] Министерство за финансии на Република Македонија (2014) *Буџет на Република Македонија за 2014 година*.
- [12] Министерство за финансии на Република Македонија (2015) *Буџет на Република Македонија за 2015 година*.
- [13] Министерство за финансии на Република Македонија (2016) *Буџет на Република Македонија за 2016 година*.
- [14] Митрески, Д (2013) Германскиот гигант Кромберг и Шуберт отвори фабриката во Македонија, *Вечер*, 18 октомври 2013. [на интернет] Достапно на <http://veser.mk/ekonomija/germanskiot-gigant-kromberg-i-shubert-otvori-fabrikata-vo-makedonija>
- [15] Службен весник на Република Македонија бр. 06/2002. *Закон за слободни економски зони 1999 година*
- [16] Службен весник на Република Македонија бр. 14/2007. *Закон за технолошки индустриски развојни зони*
- [17] Службен весник на Република Македонија бр. 57/2010. *Закон за основање агенција за странски инвестиции и промоција на извозот на Република Македонија 2010*.
- [18] European Commission (2014) *Guide to Cost-Benefit Analysis of Investment Projects, Economic appraisal tool for Cohesion Policy 2014-2020*. Brussels.
- [19] Lazarov, D. and Petreski, G. (2015) Does Innovation Capacity Constraint Economic Growth in Republic of Macedonia, *SSRN Papers*.